

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS MUNICIPALITY SUHAREKË OPSTINE SUVA REKA	
---	---	---

DREJTORIA E ARSIMIT

05nr. 790 datë 28.08.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 , nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032 , nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 , UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2018/2019

1.SHFMU"Vaso Pashë Shkodrani"-Leshan

- Një mësimdhënës për lëndën e gjuhës angleze për kohë të caktuar (deri në përfundimin e mandatit të drejtorit të shkollës).
- Një mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me plotësim orësh në shkollat tjera-rishpallje

2.SHFMU"Naum Veqilharxhi-Mohlan

- Një mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me plotësim orësh në shkollat tjera-(norma mësimore 19 orë) - rishpallje.

3.SHFMU"Edit Durham"-Mushtisht

- Një mësimdhënës të mësimi klasor për klasët e kombinuara në paralelen në Delloc për kohë të caktuar deri më 31.08.2019(zëvendësim i pushimit pa pagesë).

4. IP"Fluturat"-Suharekë

- Një edukatore për fëmijët mosha 3-5 në paralelen në Mushtisht

Kushtet:-Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018 .

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit(kërkesa)të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj(fotokopje).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,(nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati i konkurimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bytyqi

